



MANUAL NDIHMËS PËR BIZNESET GJELBËRIMI I PROCESVE

Modulet e “Përmirësimit të biznesit” ndihmojnë bizneset, që operojnë tashmë në treg, të përmirësojnë aspekte të ndryshme të procesve të tyre si marketingu, kostot, ose menaxhimi i burimeve njerëzore.

Nëse jeni një sipërmarrës ekzistues i një biznesi jo të gjelbër, përveç përmirësimit të proceseve të mësipërme, një mënyrë përmirësimi është të bëheni biznes i gjelbër!

Bizneset e gjelbërta po lulëzojnë në një numër të madh sektorësh në të gjitha vendet anembanë botës dhe nuk është e habitshme kjo për faktin se: bizneset e gjelbërta kanë një numër të madh përfitimesh, duke përfshirë aksesueshmërinë në një treg konsumator gjithnjë e më shumë mjedisor dhe të orientuar nga vlerësimi për shëndetin, ku konsumatorët duan produkte të sigurta dhe eko-miqësore dhe ku parimet e uljes së kostove dhe rritjes së produktivitetit si burime po përdoren në mënyrë efektive.

Bizneset ekzistuese mund të bëhen të gjelbërta duke shtuar një produkt ose shërbim të gjelbërt në rangun e produkteve që ata ofrojnë.

Por edhe nëse ofrojnë produkte dhe shërbime ekzistuese jo të gjelbërta, sipërmarrjet ekzistuese mund të kenë qasje të gjelbërt duke bërë proceset e tyre miqësore me mjedisin.

Ky kapitull shpjegon se çfarë do të kuptohet me gjelbërim të proceseve dhe ofron udhëzime praktike se si bëhet kjo.

Megjithëse ky kapitull ka të bëjë më shumë me bizneset ekszituese, gjithashtu shërben edhe për ata që janë në procesin e fillimit të një biznesi.

Çfarë është gjelbërimi dhe si mund të gjelbërosh proceset?

Një biznes, mund të jetë një biznes i gjelbër në dy mënyra:

- ⑩ Duke ofruar produkte dhe shërbime që janë miqësor me mjedisin;
- ⑩ Nëpërmjet procesve të biznesit/të prodhimit miqësore me mjedisin, edhe në rastet kur biznesi ofron produkte ose shërbime konvencionale/tradicionale.¹

Gjelbërimi i proceseve i referohet transformimit të proceseve të biznesit/prodhimit të ndërmarrjes në mënyrë që biznesi të kthehet i gjelbër.

Çdo ndërmarrje mund të gjelbërojë operacionet dhe proceset e saj. Kjo ka të bëjë me dy dimensione. Nga njëra anë, ka të bëjë me inputet e kërkuara dhe nga ana tjetër, ka të bëjë me prodhimin e tepërt ose mbeturinat dhe ndotjen. Pra, gjelbërimi i proceseve tuaja synon në:

① Rritjen e efikasitetit të inputeve të përdorura në ndërmarrje, d.m.th. zvogëlimi i përdorimit të energjisë, materialeve apo ujit duke rritur ose ruajtur të njëjtin nivel të ofrimit të produktit ose shërbimit;

② Uljen e sasisë së prodhimit të paqëllimshëm, d.m.th. zvogëlimi i mbeturinave, ndotjes dhe shkatërrimit të jashtëzakonshëm të burimeve natyrore.

Këshilla për gjelbërimin e proceseve

Kushtojini vëmendje lëndëve të para (burimeve/inputeve): Kur zhgjidhni lëndën e parë, mendoni qëndrueshmërinë. Kjo nënkupton që lënda e parë mund të jetë organike, e biodegradueshme, e riciklueshme ose e rinovueshme. Produktet bujqësore organike, plastika e biodegradueshme ose druri nga pyjet e lejuara për t'u prerë janë shembuj të lëndëve të para që e bëjnë biznesin tuaj më të gjelbër.

Gjelbëro biznesin me anë të konsumit të energjisë, ujit: Biznesi juaj me siguri do të ketë nevojë për energji dhe/ose ujë. Për shembull mund të gjelbëroni proceset duke përdorur energji nga burime të rinovueshme, siç është energjia diellore dhe duke përdorur ujin e filtruar të shiut. Gjithashtu mund të zvogëloni konsumin e energjisë duke përdorur pajisje më efektive. Përdorimi i energjisë dhe ujit gjithashtu mund të minimizohen nga teknologjitë që ju ndihmojnë të përdorni sa më pak të jetë e mundur, siç janë çelësat e dritës ose rubinetat me sensorë. Këto ndryshime janë të mira për mjedisin, por gjithashtu ato janë të mira për biznesin tuaj: **sa më pak të përdorni, aq më pak shpenzoni!**

Minimizoni emetimet: Kaloni tek karburantet që janë sa më të gjelbër të jetë e mundur dhe përdorni pajisje që prodhojnë sasinë më të vogël të emetimeve. Ndonjëherë një kalim nga një gjenerator me naftë në një elektrik zvogëlon kostot ndërkohë që ndihmon edhe në pastrimin e ajrit lokal. Në rast se emetimet nuk pastrohen siç duhet, mund të orientoheni drejt teknologjive të duhura të filtrimit.

Ripërdorimi dhe riciklimi i mbetjeve: Prodhoni dhe ofroni shërbime duke përdorur sa më pak të jetë e mundur. Për shembull, është e mundur që produkti juaj të pakëtohet me më pak material? Ripërdor çdo gjë që mund të ripërdoret përsëri. Paketimi i lëndës së parë që ju e merrni si furnizim për prodhimin tuaj, mund të ripërdoret për paketimin e produktit tuaj. Mbetjet që ju nuk mund t'i ripërdorni vetë ose t'ja u jepni të tjerëve për ripërdorim, riciklojini. Në shumë qytete, mbledhësit e mbetjeve paguajnë për mbetjet që çoni! Për mbetjet që nuk mund të ripërdoren ose të riciklohen, hidhini në mënyrë sa më të përgjegjshme.

Përgjegjshmëria në transport: Minimizoni distancat për transport, minimizoni në peshë dhe në volum nëpërmjet paketimit të produkteve me efikasitet, shmangni ngarkesat e vogla,

planifikoni distanca me efektivitet dhe kur transportoni zgjidhni gjithmonë opsionin më pak të dëmshëm për mjedisin. Një mundësi tjetër është edhe ndarja e transportit me të tjerë në qoftë se është e mundur.

Mendoni jashtë kuadrateve: Përdorni krijimtarinë tuaj për të fituar ndërkohë që ndihmoni mjedisin. Eko-sipërmarrësit janë të prirur për të qenë inovatorë. Disa herë, për ta kthyer një ide inovative në realitet nevojitet të kesh teknologji të sofistikuar, ekspertizë shkencore ose sasi të madhe parash. Por ndonjëherë mund të përdorni burime që janë të disponueshme në komunitetin tuaj dhe t'i transformoni ato duke gjeneruar edhe fitim. Mund të keni dëgjuar për ide inovative, siç janë eko-ftohësit të bërë nga shishe plastike të hedhura, ose gota dhe pllaka të bërë nga bluajtës kafeje, apo edhe të sipërmarrësve që krijojnë shërbime nga produktet sepse një konsumator shpesh është më i interesuar për cilësinë e shërbimit (p.sh. dritën) sesa për vetë produktin (p.sh. një fanar/llambë). Sipërmarrësit kanë filluar të shesin dritë duke karikuar fenerë diellorë gjatë ditës dhe duke i shpërndarë ato plotësisht të karikuara për familjet në orët e mbrëmjes. Jini krijues në mendimin tuaj dhe mund të bëheni një eko-novator.

MËNYRA TË THJESHTA PËR TË NDIHMUAR MJEDISIN DHE BIZNESIN: STRATEGJIA E 3R-ve

Nëse menaxhon mbetjet duke përdorur strategjinë e 3 R-ve, ti ndihmon mjedisin nëpërmjet:

- **Redukto:** Krijimi i mbeturinave mund të minimizohet duke zvogëluar konsumin tonë. Ne mund të blejmë më pak, dhe mund të blejmë produkte më të qëndrueshme që zgjasin më shumë, që do të thotë më pak produkte të reja dhe më pak mbeturina.
- **Ripërdor:** Gjithashtu ne mund të ripërdorim gjërat në një mënyrë tjetër për të zvogëluar sasinë e mbeturinave që prodhojmë. Objektet e vjetra mund të ripërdoren në një mënyrë tjetër në vend që të hidhen larg.
- **Riciklo:** Kur reduktimi ose ripërdorimi nuk janë të mundur, riciklimi mund të përdoret për të prodhuar lëndë të para të reja nga mbeturinat; në këtë mënyrë, mbeturinat nuk hidhen, dhe përveç kësaj nuk është e nevojshme të shfrytëzojmë mjedisin natyror për të nxjerrë lëndën e parë.

Megjithëse "R"-të e mësipërme janë 3 "R"-të bazë më të përdorura, strategjisë suaj të gjelbërimit mund t'i shtohen edhe më shumë elementë psh. kompostimi i mbetjeve një mënyrë për të trajtuar mbeturinat organike, dhe "Riparimi" është një mjet i dobishëm për të zgjatur më shumë jetën e produkteve nëse prishen.

Të gjitha këto "R" kanë një impakt pozitiv në jetën e biznesit. Ju mund të kurseni para duke zvogëluar sasinë e inputeve/burimeve që përdorni, dhe duke ripërdorur gjithçka që mund të shfrytëzohet. Më në fund, jo vetëm që mund të kurseni para në këtë mënyrë, por duke i'u shitur mbeturinat tuaja atyre që operojnë në biznesin e riciklimit ose pajisjet që nuk ju duhen më, për të tjerët që i kërkojnë ato pajisje, mund të gjeneroni edhe të ardhura!

TË KURSESH NËPËRMJET GJELBËRIMIT

A e dini se mund të kurseni para duke qenë miqësor me mjedisin? Disa shembuj se si mund të ndihmoni mjedisin dhe të ulni kostot në të njëjtën kohë::

- **Reduktimi/ulja e përdorimit.** Ulja e kostove dhe ulja e faturave është po aq e lehtë sa përdorimi i energjisë elektrike dhe ujit vetëm kur ju nevojitet vërtetë. Instalimi i rubinetave me sensorë ose fikja automatike e dritës ju ndihmon ta bëni këtë.
- **Bëni zgjidhje efikase.** Për shembull, për sa i përket përdorimit të energjisë, duke zgjedhur opsione të energjisë efikase në ndriçim, siç janë dritat LED dhe CFL në vend të llambave tradicionale të dritës inkandeshente, ju mund të zvogëloni sasinë e energjisë që përdorni me 50 përqind ose më shumë për shkak të efikasitetit të tyre. Në terma monetarë, zëvendësimi i një llambë tradicionale me një CFL të së njëjtës shkëlqim do t'ju kursejë rreth 7 dollarë në vit, ose 87 dollarë gjatë jetës së llambës. Mendoni për këtë kur t'i vendosni në ambientet e biznesit tuaj dhe zgjidhni pajisjet!
- **Ndërroni burimet.** Për shembull, filloni të përdorni energjinë diellore në vend të energjisë së rregullt. Do të duhet të paguani për investimin fillestar, instalimin e paneleve diellore, por më pas do të keni burim energjie që është falas.

Mendoni se sa mund të kurseni nëse do të zbatonit disa nga këto masa në biznesin tuaj!!

1. Vlerëso

Përshtatni dhe përdorni listën e gjelbërimit më poshtë për të vlerësuar situatën tuaj aktuale.

Lista për gjelbërim:

		PO	JO	N/A	MASA E GJELBËRIMIT
SIGURIMI I GJELBËRIMIT	Përdorni materiale miqësore me mjedisin (të ricikluara, të riciklueshme, të përdorura, organike, natyrale, të biodegradueshme...)				
	Përdorni materiale lokale?				
	Furnizoheni nga furnitorë që përpiqen të jenë miqësore me mjedisin?				

RUAJTJA E ENERGISË DHE UJIT	Përdorni energji elektrike nga burimet e rinovueshme?				
	Përdorni pajisje efikase?				
	Përdorni vetëm aq energji elektrike sa ju nevojitet?				
	Përdorni ujë nga burime të rinovueshme (ujë shiu të filtruar)?				
	Përdorni ujë vetëm sa të jetë e nevojshme?				
DISPOZITA TË PARANDALIMIT TË NDOTJES NË PRODHIM / SHËRBIM	Përdorni pajisje me emetim të ulët?				
	Operoni me efikasitet?				
	Shmangni përdorimin e kimikateve të rrezikshme ose substancave të tjera që mund të shkaktojnë ndotje të ajrit, tokës apo ujit?				
	Minimizoni emetimin e ndotësve në mjedis përmes masave si filtrimi i ajrit apo ujit?				
RICKLIMI DHE REDUKTIMI I MBETJEVE	Reduktoni sa më shumë të jetë e mundur?				
	Ripërdorini sa më shumë të jetë e mundur?				
	Ricikloni sa më shumë të jetë e mundur?				
	Kompostoni çfarëdo që mund të kompostohet?				
	Ndani mbetjet?				
	Hidhni ato mbetje që duhet në një vend të sigurt dhe mënyrë e përshtatshme?				
TRANSPORT I GJELBËR	Shmangni transportin në destinacione larg?				
	Shmangni transportimin e sendeve individuale / grupeve të vogla të artikujve?				
	Përdorni mënyrat më pak ndotëse të mundshme të transportit?				
	Përdorni ofruesit e transportit të cilët përpiqen të jenë miqësorë me mjedisin?				
TJETËR	Në ambientet tuaja, keni mobilje që janë të përdorura ose të bëra nga materiale të rinovueshme ose të riciklueshme?				
	A i ndani pajisjet me të tjerët kur është e mundur?				
	A vini në punë, ju (dhe punonjësit tuaj) në mënyrë miqësore me mjedisin? (ecni, pedalon, përdorni një makinë për disa persona...)				

2. Planifikimi

Përcaktimi i përparësive

Bazuar në vlerësimin e mësipërm, duhet të keni identifikuar një numër masash të mundshme të gjelbërimit.

Ndërsa nuk mund të bësh gjithçka menjëherë, do të duhet të vendosësh se ku të fillosh. Për t'ju ndihmuar të vendosni për përcaktimin e veprimeve prioritare, mund të përdorni matricën e përparësisë.

Plotësoni për modelin e biznesit tuaj duke përdorur simbolet e mëposhtme:

++ Shumë pozitiv/shumë e lehtë + Pozitive/e lehtë

0 As positive/e lehtë as negative/e vështirë

- Negative/e vështirë

-- Shumë negative/shumë e vështirë

Matrica e përparësive

MASAT E GJELBËRTA	NDIKIMI NË BIZNES	NDIKIMINË MJEDIS	LEHTËSIA NË VËNIEN NË PUNË	LEHTËSIA NË FINANCIM

Bazuar në përgjigjet tuaja, do të shihni që disa masa janë më të rëndësishme se sa të tjerat për sa i përket ndikimit, dhe disa janë më të lehta për t'u bërë dhe për t'u financuar se të tjerat. Ju do të duhet të gjeni një ekuilibër midis asaj që është e rëndësishme dhe asaj që është realiste. Shikoni tabelën tuaj dhe përcaktoni përparësitë në bazë të saj.

Planifiko

Bazuar në ushtrimin e prioritizimit më lart, bëni një plan gjelbërimi. Vendosni se çfarë duhet të bëhet, kur dhe nga kush, sa do të kushtojë dhe si mund të mbulohet kostoja.

Është e rëndësishme të jesh realist kur planifikon. Edhe nëse një veprim mund të ketë një ndikim shumë pozitiv në mjedis dhe në biznes, nëse nuk keni burime për ta zbatuar atë, mund t'ju duhet të filloni me veprime të tjera ndërsa punoni për të gjetur burimet e kërkuara për të.

Përshtatni dhe përdorni planin e gjelbërimit për gjelbërimin e biznesit tuaj.

Plani i Gjelbërimit:

MASAT E GJELBËRTA	KUR DO TË PËRFUNDOJË	KUSH DO TA BËJË	SA DO TË KUSHTOJË	SI MUND TË MBULOHEK KOSTO

Monitoro

Është e rëndësishme që të rishikoni vlerësimin tuaj dhe të planifikoni rregullisht. Të gjithë jemi të zënë dhe ndonjëherë harrojmë qëllimet që i kishim vendosur më herët, kështu që sigurohuni që rregullisht të rivlerësoni biznesin tuaj.

Për t'u siguruar që jeni në rrugën e duhur, kthejuni listës tuaj të gjelbërimit dhe planit të gjelbërimit një herë në gjashtë muaj. Kjo do t'ju ndihmojë të bëni ndonjë rregullim të nevojshëm për të arritur qëllimet tuaja!

i